



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

NR. 106 AKTI

NR. 141 VENDIMI

Tiranë, më 18.4.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja - Kryesuese

Pamela Qirko - Anëtare

Genta Tafa (Bungo) – Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, më datë 16.4.2019, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve (ish- pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Esmeralda Xhili (Çeka)**, gjyqtare/kryetare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE : **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (referuar më poshtë “Kushtetuta”).

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (referuar më poshtë “ligji nr. 84/2016”);

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, atë pasuror, të figurës dhe vlerësimin profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, znj. **Esmeralda Çeka**, ushtron detyrën e gjyqtarit/kryetarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, detyrë të cilën e ka filluar në vitin 2007 dhe, në bazë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Ajo i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më datë 15.3.2018 në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 26.3.2018 u caktua me mirëkuptim kryesuesi i trupit gjykues, znj. Etleda Çiftja, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga asnjë prej anëtarëve të trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Esmeralda Çeka.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) ka kryer procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. *** prot., datë 20.02.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

- 1) *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- 2) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- 3) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- 4) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- 5) *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të

papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit 84/2016, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 11.4.2018, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Esmeralda Çeka.*

Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 5.3.2019.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 5.4.2019 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit më datë 5.4.2019. Subjekti i rivlerësimit ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më datë 9.4.2019.

Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, më datë 12.4.2019.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 16.4.2019, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve (ish- Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, duke shprehur opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Esmeralda Çeka ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ajo ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit;
- dh) deklaratimet e personave të tjerë të lidhur.

Në deklaratën e pasurisë “Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, **subjekti deklaron këto pasuri** (të paluajtshme dhe të luajtshme):

1. Tokë arë dhe ullishte në bashkëpronësi, gjithsej 4.800 m², e ndodhur në fshatin ***, Ndroq, Tiranë.

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: Përfitur nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën”, si anëtare e familjes bujqësore;

2. Shtëpi banimi e babait Z. Ç., pasuria me nr. ***, truall dhe ndërtesë 300 m², e ndodhur në Ndroq, Tiranë, pjesë të së cilës e përdor për nevoja banimi, jo përkundrejt një vlere monetare. Jeton në këtë shtëpi banimi, shtëpi që është ndërtuar që në vitin 1990.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: Shtëpia është ndërtuar nga të ardhurat e punës së prindërve.

Në lidhje me këtë apartament, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Aktin e marrjes së tokës në pronësi, datë 4.11.1992, në emër të Z. Ç., me sipërfaqen 4800 m²;
- Kthim përgjigje, datë 31.10.2016, nga ZVRPP-ja Tiranë;
- Vërtetim i njësisë me origjinalin nr. *** rep., datë 13.10.2016;

- Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 25.5.2015, për truall me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtesë 140 m², në Ndroq, Tiranë, në pronësi të Z. Ç.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

- Shkresë nr. *** prot., datë 30.3.2018, drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë

Kthim përgjigje ZVRPP-ja Tiranë, nr. *** prot., datë 30.4.2018

- Shkresë nr. *** prot., datë 7.1.2019, drejtuar Zyrës Qëndrore të Pasurive të Paluajtshme

Kthim përgjigje ZVRPP-ja Tiranë, nr. *** prot., datë 17.1.2019

Arsyetimi ligjor

A. Më datë 4.11.1992, numër regjistrimi akti s'ka, z. Z. Ç. me aktin e marrjes së tokës në pronësi ka përfituar 4800 m² tokë.

Bazuar në certifikatën familjare të datës 3.3.2015, në përbërjen familjare të z. Z. Ç., më datë 1.8.1991, ka qenë dhe subjekti i rivlerësimit, e cila në cilësinë e anëtarit të familjes bujqësore, bazuar në ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", përfiton pjesën e saj takuese.

Kjo pasuri rezulton e regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, si më poshtë:

- Pasuri e llojit arë, me nr. ***, ndodhur në zonën kadastrale ***, me adresë ***, Tiranë, me sipërfaqe 3600 m².
- Pasuri e llojit arë, me nr. ***, ndodhur në zonën kadastrale ***, me adresë ***, Tiranë, me sipërfaqe 1200 m².

Për këtë pasuri i është kërkuar informacion subjektit të rivlerësimit në lidhje me shfrytëzimin e saj, subjekti sqaron se:

"Toka bujqësore është fituar sipas ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 "Për tokën". Duke qenë se në datë 1.8.1991, unë, prindërit dhe vëllai im E. Ç., kemi qenë në të njëjtën përbërje familjare, rrjedhimisht, konsiderohemi në kuptim të ligjit, bashkëpronarë. Si e tillë, si bashkëpronare, unë nuk kam shitur, dhuruar apo tjetërsuar pjesë të kësaj pasurie. Po kështu, si bashkëpronare, unë nuk kam dhënë me qira apo në përdorim pjesë të kësaj pasurie. Vëllai im E. Ç. jeton jashtë vendit prej shumë vitesh, prindërit e mi janë pensionistë dhe unë jam marrë me studime, dhe rrjedhimisht, me sa kujtoj dhe me sa kam dijeni, nuk kemi prodhuar produkte bujqësore në këtë tokë. Në dijeninë time, kjo tokë nuk është dhënë me qira dhe nuk përdoret nga ndonjë person. Me sa kam pyetur familjarët e mi, edhe ata nuk kanë nënshkruar ndonjë akt noterial, për shitje, dhurim, dhënie me qira, përdorim etj., të kësaj pasurie. Me sa jam në dijeni, në këtë tokë, nuk ka ndërtime."

B. Bazuar në vërtetimin datë 3.3.2015 të kryesisë së fshatit Ndroq, (që i është bashkëlidhur përgjigjes së ZVRPP-së), rezulton se, babai i subjektit të rivlerësimit para vitit 1990 ka ndërtuar një shtëpi me kontribulet e veta, e cila është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në vitin 1997. Shtëpia figuron e regjistruar në zonën kadastrale *** dhe ka numër pasurie ***, lloji i pasurisë truall, me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe *** m².

Subjekti ka deklaruar se ende vazhdon të banojë në këtë banesë. Ndërsa në lidhje me mobilimin e kësaj banese, subjekti ka sqaruar se ajo është mobiluar që në kohën kur është ndërtuar, pra, në vitin 1990, duke u rinovuar me orëndi të caktuara rast pas rasti.

Bashkëlidhur përgjigjes, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion:

- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për periudhën 1.1.1994-30.6.2006 të znj. V. Ç.;
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për periudhën 1.8.1997-31.1.2005 të z. Z. Ç.;
- Vërtetim nr. *** prot., datë 15.1.2019 i Drejtorisë Rajonale Tiranë të ISSH-së ku vërtetohet se znj. V. Ç. për periudhën 29.7.2006-30.12.2018 ka patur të ardhura në shumën 3, 224, 806 lekë;
- Vërtetim nr. *** prot., datë 15.1.2019 i Drejtorisë Rajonale Tiranë të ISSH-së ku vërtetohet se z. Z. Ç. për periudhën 20.01.2005-30.12.2018 ka patur të ardhura në shumën 3, 654, 993 lekë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni konstaton se kjo pasuri është ndërtuar dhe regjistruar në periudhën kur znj. Çeka ka qenë e mitur.

Në përfundim, Komisioni çmon se nga vlerësimi i provave të marra gjatë këtij hetimi administrativ, nuk lindin dyshime apo paqartësi për këtë pasuri të paluajtshme.

C. Bazuar në shkresën e ZVRPP-së rezulton se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë patur në bashkëpronësi pasurinë me numër hipotekor ***, datë 26.12.2001, zona kadastrale rurale, lloji i pasurisë apartament, me sipërfaqe 75 m².

Me kontratën nr. ***, datë 18.12.2001, prindërit e subjektit, së bashku me familjen e motrës së saj, kanë privatizuar një apartament, me sipërfaqe 75 m², për shumën 9, 275 lekë.

Ky apartament rezulton të jetë i privatizuar fillimisht në datë 24.12.1994 nga ana e z. S. B. (bashkëshorti i motrës së subjektit të rivlerësimit), i cili ka bërë dhe pagesën në shumën 1,312 lekë, më datë 24.12.1994. Në këtë kontratë parashikohet se nëse pagesa nuk bëhet për 6 muaj radhazi, kontrata konsiderohet e prishur dhe banesa kalon në pronësi të shtetit dhe qytetari kthehet në qiramarrës. Në formularin 2 me emërtim “Treguesit kryesorë për apartamentin” në pikën 7, numri i frymëve shënohet 8, ndërsa në pikën 8, numri i familjeve shënohet 2. Bashkëlidhur gjenden dy certifikata familjare, një e z. S. B. dhe një e z. Z. Ç., ku në përbërjen familjare të tij rezulton dhe subjekti i rivlerësimit.

Pavarësisht pikëpyetjeve që lindin në privatizimin e këtij apartamenti, konstatohet se subjekti në këtë kohë ka qenë vetëm 14 vjeç dhe nuk ka qenë pjesë e kontratës së privatizimit. Gjithashtu, nga hetimi administrativ rezulton se ky apartament është shitur me kontratën nr. ***, datë 14.07.2005, për shumën 1,900, 000 lekë. Edhe në këtë kontratë shitblerje, subjekti nuk figuron palë.

- ✓ Në përfundim, Komisioni konkludon se subjekti ka deklaruar në mënyrë të saktë në deklaratën “Vetting”. Ky deklaram përputhet me të dhënat e administruara nga hetimi administrativ.

3. Automjet Ford Fiesta, me targa ***, vit prodhimi 1997, me vlerë 254, 496 lekë, në pronësi të babait Z. Ç. Ky automjet përdoret kryesisht nga ana e saj, jo përkundrejt një vlere monetare.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: Blerë nga babai Z. Ç., me të ardhurat e prindërve, të cilët kanë punuar që në rininë e tyre dhe në vitet 2005, 2006, kanë dalë në pension pleqërie.

Për këtë pasuri, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Kthim përgjigje nr. *** prot., dt. 21.10.2016, nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë për automjetin ***, në pronësi të shtetasit Z. Ç.
- Leje qarkullimi e mjetit Ford Fiesta, me targa ***, në emër të Z. Ç.
- Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 28.10.2016, nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë, për automjetin ***, në pronësi të shtetasit Z. Ç.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit

- **Shkresë nr. *** prot., datë 30.03.2018 drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë**

Kthim Përgjigje nr. *** prot., datë 10.04.2018 e DRSHTRR-së Tiranë

- **Shkresë nr. *** prot., datë 10.01.2019 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor**

Kthim përgjigje DPSHTRR-ja, nr. *** prot., datë 17.1.2019

Arsyetimi ligjor

Më datë 9.3.2009, me faturë tatimore nr. ***, babai i subjektit të rivlerësimit ka blerë mjetin tip Ford Fiesta, për shumën 254,496 lekë.

I është kërkuar informacion subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë automjet. Në përgjigjen e saj ajo sqaron se: *“Siç kam theksuar, unë kam përdorur më parë, automjetin “Ford Fiesta” me targa ***, vit prodhimi 1997, në pronësi të babait tim Z. Ç. Ky automjet është përdorur nga ana ime, më parë, jo përkundrajt një vlere monetare. Ka kohë që nuk e përdor këtë automjet, pasi për shkak të defekteve teknike, u bë i papërdorshëm dhe me sa di, është çregjistruar, pasi nuk është më pjesë e qarkullimit civil.”*

Në lidhje me burimin e të ardhurave subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacionin e cituar më lart.

Ky mjet rezulton të jetë hequr përfundimisht nga qarkullimi më datë 28.4.2017, për arsye se është nxjerrë jashtë përdorimit.

- ✓ Komisioni konkludon se subjekti ka deklaruar me saktësi në deklaratën “Vetting” të dhënat mbi këtë pasuri të luajtshme.

4. Lidhur me:

(a) Llogari plan kursimi, me gjendje 95.736.33 lekë.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: Kjo llogari është krijuar nga derdhjet periodike nga llogaria e pagës si gjyqtare.

(b) Llogari rrjedhëse, aktualisht deri më datë 24.1.2017, gjendja është 28.765 lekë.

Subjekti ka dorëzuar këto dokumente:

- Vërtetim nga Intesa San Paolo Bank, datë 24.1.2017.

Hetimi i Kryer nga ana e Komisionit

- **Shkresë nr. *** prot., datë 30.3.2018, drejtuar bankave**

Kthim përgjigje Intesa San Paolo Bank, nr. *** prot., datë 11. 4.2018

Arsyetimi ligjor

Komisioni hetoi në lidhje me llogaritë bankare të subjektit. Nga administrimi i përgjigjeve nga bankat e nivelit të dytë, konfirmohet deklarimi i subjektit për llogaritë:

- Llogari rrjedhëse, me gjendje 27,765 lekë, më datë 24.1.2017;
- Llogari plan kursimi, me gjendje 95,736.33 lekë, më datë 24.1.2017.

Të ardhurat e këtyre llogarive janë rezultat i të ardhurave nga paga e subjektit.

- ✓ Komisioni konkludon se subjekti ka qenë i saktë në deklarimin e tij.

5. Në lidhje me likuiditetet:

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit

- **Shkresë nr. ***prot., datë 30.3.2018, drejtuar bankave**

Kthim përgjigje Union Bank, nr. *** prot., datë 25.4.2018;

Kthim përgjigje Raiffeisen Bank, nr. *** prot., datë 10.4.2018

- **Shkresë nr. *** prot., datë 7.1.2019, drejtuar Raiffeisen Bank**

Kthim përgjigje Raiffeisen Bank, nr. *** prot., datë 9.1.2019

Arsyetimi ligjor

A. Bazuar në shkresën e Union Bank rezulton se subjekti i rivlerësimit ka patur llogari bankare në këtë bankë, e cila është hapur me qëllim shlyerjen e kredisë së marrë dhe të deklaruar nga ana e saj në deklaratën e interesave private të vitit 2012.

B. Bazuar në shkresën e Raiffeisen Bank rezulton se subjekti i rivlerësimit ka marrë tri kredi, si më poshtë:

1. Kredi e marrë më datë 13.4.2017, në shumën 8,700,000 lekë. Aktualisht detyrimi i pashlyer 8,289,023.92 lekë (trajtuar më poshtë në këtë vendim);
 2. Kredi e marrë më datë 30.11.2010, në shumën 18,600 lekë, mbyllur më datë 30.12.2013;
 3. Kredi e marrë më datë 14.10.2008, në shumën 400,000 lekë, mbyllur më datë 16.4.2012. Kjo kredi është marrë në datë 14.10.2008 për afat 42 muaj.
- ✓ Nga analiza e të dhënave të administruar nga hetimi administrativ, rezulton se subjekti ka qenë korrekt në deklaratat e tij përpara Komisionit. Nuk ka dyshime për veprime që mund të cenojnë figurën e gjyqtarit.

6. Bazuar në përgjigjet e pyetësorit standard, të dhënat nga hetimi administrativ, si dhe deklaratën e interesave periodikë të pasurisë për vitin 2017, rezulton se subjekti ka lidhur martesë ligjore¹, me zotën A. Xh.

Duke qenë se ishte e paqartë se kur kishte nisur bashkëjetesa me shtetasin A. Xh., Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimin informacion. Në përgjigjen e saj, subjekti deklaroi se pavarësisht se janë të martuar, ata ende nuk e kanë filluar bashkëjetesën.

Nga analiza financiare rezulton se shpenzimet e kryera për lindjen e fëmijës së tyre mbulohen nga të ardhurat e realizuara.

Subjekti gjithashtu ka deklaruar edhe blerjen e një apartamenti me sipërfaqe 82.5 m² në bashkëpronësi me z. A. Xh., ndodhur në Tiranë. Ky deklaram është bërë në deklaratën e interesave private për vitin 2017.

Komisioni ka hetuar në lidhje me këtë pasuri:

- **Shkresë nr. *** prot., datë 30.3.2018 drejtuar Zyres Vendore të Pasurive të Paluajtshme Tiranë**

Kthim përgjigje *** prot., datë 25.4.2018, ZVRPP-ja Tiranë;

Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 30.4.2018, ZVRPP-ja Tiranë.

- **Shkresë nr. *** prot., datë 30.3.2018, drejtuar bankave**

Kthim përgjigje Raiffeisen Bank, nr. *** prot., datë 10.4.2018

- **Shkresë nr. *** prot., datë 7.1.2019, drejtuar bankave**

Kthim përgjigje Credins Bank, nr. *** prot., datë 14.2.2019;

Kthim përgjigje Alpha Bank, nr. *** prot., datë 14.1.2019;

Kthim përgjigje BKT, nr. *** prot., datë 18.1.2019;

Kthim përgjigje Raiffeisen Bank, nr. *** prot., datë 14.1.2019;

Kthim përgjigje Intesa San Paolo Bank, nr. *** prot., datë 22.1.2019;

Kthim përgjigje Abi Bank, nr. *** prot., datë 23.1.2019

- **Shkresë nr. *** prot., datë 7.10.2019 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve**

Kthim përgjigje DPT-ja nr. *** prot., datë 10.1.2019;

Shkresë DPT-ja nr. *** prot., datë 10.1.2019 drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë për dijeni KPK-së.

Kthim përgjigje Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, nr. *** prot., datë 7.1.2019

- **Shkresë nr. *** prot., datë 7.1.2019, drejtuar QKB-së**

Kthim përgjigje QKB-ja, nr. *** prot., datë 10.1.2019

- **Shkresë nr. *** prot., datë 11.12.2018 drejtuar QKB-së**

Kthim përgjigje QKB-ja, nr. *** prot., datë 12.12.2018

¹ Shkresa nr. ***prot., datë 17.12.2018 e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile

➤ **Shkresë nr. *** prot., datë 11.12.2018 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve**

Kthim përgjigje DPT-ja, nr. *** prot., datë 13.2.2018;

Shkresë nr. *** prot., datë 13.12.2018 e DPT-së, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë dhe për dijeni KPK-së;

Kthim përgjigje Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, nr. *** prot., datë 27.12.2018

➤ **Shkresë nr. *** prot., datë 11.12.2018 drejtuar UKT-së**

Kthim përgjigje UKT-ja, nr. *** prot., datë 22.12.2018

➤ **Shkresë nr. *** prot., datë 11.12.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor**

Kthim përgjigje DPSHTRR-ja, nr. *** prot., datë 13.12.2018;

Kthim përgjigje DPSHTRR-ja, nr. *** prot., datë 20.12.2018

➤ **Shkresë nr. *** prot., datë 11.12.2018, drejtuar Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme**

Shkresë nr. *** prot., datë 14.12.2018 e ZQRPP-së drejtuar zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe për dijeni KPK-së;

Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 26.12.2018 e ZVRPP-së Tiranë;

➤ **Shkresë nr. *** prot., datë 11.12.2018 drejtuar OSHEE-së**

Kthim përgjigje OSHEE-ja, nr. *** prot., datë 31.12.2018

➤ **Shkresë nr. *** prot., datë 11.12.2018, drejtuar bankave**

Kthim përgjigje BKT-ja, nr. *** prot., datë 17.12.2018

Arsyetim ligjor

A. Subjekti i rivlerësimit ka në pronësi pasurinë nr. ***, ndodhur në zonën kadastrale ***, apartament, me sipërfaqe 82.5 m² në bashkëpronësi me z. A. Xh.

Ky apartament, është blerë më datë 8.2.2017, me kontratë shitje pasuri e paluajtshme me kusht kreditimi nr. ***, me çmimin 80, 000 euro, konvertuar në lekë në shumën 10, 886,400. Bazuar në dokumentacionin e administruar, rezulton se pagesat për këtë apartament janë bërë të gjitha nëpërmjet sistemit bankar si më poshtë:

- Me mandatdepozitimi datë 8.2.2017, është depozituar shuma 5.000 nga z. A. Xh., për llogari të noterit publik, znj. M. D., e cila ka qenë noteri që ka përgatitur kontratën e shitjes së këtij apartamenti.
- Me mandatdepozitimi datë 7.3.2017, është depozituar shuma 12.000 euro nga z. A. Xh. për llogari të noterit publik, znj. M. D.
- Me njoftim kreditimi datë 13.04.2017, subjekti i rivlerësimit ka depozituar shumën 64,064.8 euro në llogarinë e noterit publik, znj. M. D.

Bazuar në deklaratën noteriale nr. ***, datë 13.04.2017, znj. E. H. dhe znj. M. S. deklarojnë se: “Blerësit znj. Esmeralda Çeka dhe z. A. Xh. kanë bërë likuidimin total të çmimit të shitblerjes së apartamentit.”

B. Si burim për blerjen e këtij apartamenti është deklaruar:

- Kredi e marrë në Raiffeisen Bank;
- Hua e marrë nga bashkëshorti A. Xh., në shumën 12.000 euro, shtetasit A. M.;
- Kursime nga paga e subjektit dhe bashkëshortit të saj, në shumën 5.000 euro;

B/1. Më datë 31.3.2017 subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëshortin e saj, me kontratë kredie dhe hipoteke nr. ***, kanë marrë kredi me afat 180 muaj, në shumën 8,700,000 lekë, me qëllim blerje shtëpie.

Në nenin 1 të kontratës së kredisë përcaktohet se shuma prej 8,700,000 lekë do të transferohet në llogarinë e noteres M. D. Bazuar në nenin 6 të kësaj kontrate rezulton se për të siguruar këtë kredi është vënë në hipotekë apartamenti i blerë.

B/2. Nga ana e Komisionit është hetuar në lidhje me të ardhurat e z. A. M., me cilësinë e huadhënësit të bashkëshortit të subjektit, nga ku ka rezultuar se:

- Bazuar në shkresën e QKB-së, rezulton se z. A. M. është i regjistruar:
 - Si person fizik me NIPT ***;
 - Si administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë “****” me NIPT ***.
- Nga ana e DRT-së Tiranë jemi informuar se z. A. M. është i regjistruar si:
 - Person fizik me NIPT ***; nuk ka deklaruar tatim mbi fitimin;
 - Si administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë “****” me NIPT ***, regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, më datë 18.9.1991, me aktivitetet: shtypshkrime të tjera, broshura, katalog, libra.

Nga verifikimi rezulton se subjekti “****” nuk ka kryer shpërndarje dividendi.

Në zbatim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016 i është kërkuar subjektit të rivlerësimit të dorëzojë dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të ardhurave të z. A. M.

Subjekti i rivlerësimit sqaron si më poshtë: *“Lidhur me pyetjen nr. 3, po ju vë në dispozicion ekstrakt historik të shoqërisë “****” “****”, ortak i së cilës është shtetasi A. M.; vërtetim për pagën e shtetasit A. M. (për një pjesë të viteve); vërtetim për bazën e vlerësuar të marrë nga DRSSH-së Tiranë, për shtetasin A. M.”*

Subjekti ka bashkëlidhur dokumentacionin e mëposhtëm:

- Ekstrakt historik i regjistrimit tregtar, datë 16.1.2019 (nxjerrë nga e-albania) i subjektit “****” me administrator dhe ortak të vetëm z. A. M.;
- Vërtetim për bazën e vlerësuar nr. *** prot., datë 16.1.2019 i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë për z. A. M.;
- Vërtetim, datë 15.1.2019, i “****” për pagat e z. A. M.

Nga përgjigja e bankave rezulton se z. A. M. ka llogari ose ka patur llogari në bankat: Credins Bank, Alpha Bank, BKT, Raiffeisen Bank, Intesa San Paolo Bank, Abi Bank.

Komisioni konstatoi se bazuar në nxjerrjen e llogarisë së pagës në Raiffeisen Bank rezulton se z. A. M. pagën e tij ia kthen sërish shoqërisë.

Duke qenë se nga informacioni i administruar rezulton se shoqëria “****” nuk ka shpërndarë dividend, si dhe konstatimit se të ardhurat nga paga të z. A. M. i kthehen

mbrapsht kësaj shoqërie, subjektit të rivlerësimit iu kërkua informacion shtesë në lidhje me burimin e ligjshëm të ardhurave të z. M. për dhënien e huas në shumën 12,000 euro.

Subjekti i rivlerësimit sqaron se: *“Në vijim të e mail-it nga ana juaj, po ju vë në dispozicion deklaratë noteriale nr. *** rep., *** kol., datë 3.3.2017, me deklarues z. A. M. dhe z. A. Xh. Duke qenë në marrëdhënie të posaçme familjare, bashkëshorti A. Xh. dhe daja i tij A. M., nuk kanë përpiluar një kontratë huaje me shkrim, por për të evidentuar marrjen e shumës së parave hua, është përpiluar përpara noterit deklarata noteriale e sipërcituar, që në mars të vitit 2017. Po ju dërgoj deklaratën noteriale.*

*Në lidhje me dokumentacionin ligjor për aftësinë huadhënëse të z. A. M., po ju vë në dispozicion "Ndryshim kontrate kredie me kufi nr. *** rep., *** kol., datë 13.2.2014", e cila mban datë 17.2.2016, me nr. *** rep., *** kol., lidhur midis "Raiffeisen Bank" sh.a. kredihënës dhe shoqëria "****" sh.p.k, kredimarrës dhe z. A. M. dorëzanës. Në përmbajtje, rezulton se është rënë dakord për rinovimin e linjës së kredisë me kufi për shumën përkatëse të shënuar në kontratë. Gjithashtu, po ju vë në dispozicion edhe statement/lëvizjet e llogarisë bankare, për një periudhe të caktuar kohore, të shoqërisë "****", ortak dhe administrator i vetëm i së cilës, është z. A. M.”*

Në përgjigjen e saj, subjekti ka bashkëlidhur:

- Nxjerrje llogarie në lekë e shoqërisë “****” sh.p.k nga Raiffeisen Bank;
- Ndryshim kontratë kredie nr. ***, datë 17.2.2016, lidhur midis Raiffeisen Bank dhe shoqërisë “****”;
- Deklaratë noteriale nr. ***, datë 3.3.2017, me deklarues z.A. M. dhe z. A. Xh.

Në deklaratën noteriale nr. ***, datë 3.3.2017, me deklarues z. A. M. dhe z. A. Xh., parashikohet se: *“...z. A. M. në muajin shkurt të vitit 2017 i ka dhënë hua nipit të tij z. A. Xh., shumën prej 12.000 euro, pa interes, shumë e cila do të kthehet brenda vitit 2020...z. A. M. deklaroi se shumën 12,000 euro e ka përfituar nga të ardhurat personale nga biznesi i tij.”*

Nga kjo deklaratë rezulton se burimi i të ardhurave të z. M. për dhënien e huas, janë të ardhurat personale nga biznesi i tij.

Në përfundim të hetimit, Komisioni konstatoi se dokumentacioni i depozituar nuk është i mjaftueshëm për të provuar aftësinë paguese të z. A. M., si individ, për dhënien e huas në shumën 12.000 euro z. A. Xh.

Për këtë rezultat hetimi, subjektit iu kërkuan shpjegime të bindshme për të provuar se A. M. ka të ardhura personale të mjaftueshme për dhënien e huas në shumën 12, 000 euro. Në përgjigjen e subjektit, pas njohjes me rezultatet e hetimit, sqarohen lidhjet e ngushta familjare midis bashkëshortit të subjektit dhe dajës së tij.

Subjekti ka sqaruar se: *“... Nuk kishte arsye nga ana ime, për të dyshuar mbi ligjshmërinë e burimit të kësaj shume parash, të dhëna hua bashkëshortit tim, nga ana e dajës së tij, z. M. Kjo pasi, në dijeninë time, z.M. ushtronte një aktivitet të ligjshëm, në një shoqëri me kapital themeltar të konsiderueshëm; ishte ortak i vetëm dhe administrator në shoqëri; bënte një jetë të rregullt familjare; gëzonte respekt në komunitetin e tij; kishte lidhje gjaku dhe shumë të ngushta me familjen e bashkëshortit tim.*

Për këtë arsye, në momentin që bashkëshorti im ka marrë këtë shumë parash, hua nga daja e tij, edhe unë shpreha dakordësinë që kjo shumë parash (në raport me vlerën totale të blerjes së apartamentit, kjo shumë përfaqëson një shumë relativisht të vogël), të

*përdorej për blerjen e apartamentit, nga ana ime dhe e bashkëshortit. Është e kuptueshme që në momentin që është marrë kjo hua, për shkak edhe të pozitës time në raport me dajën e bashkëshortit, nuk jam informuar për faktin nëse shoqëria, ortak i vetëm i së cilës është daja i bashkëshortit, kishte shpërndarë (ose jo) fitim.....duke qenë ortak i vetëm i shoqërisë “***” sh.p.k., por njëkohësisht edhe administrator i vetëm i kësaj shoqërie, nga llogaritë bankare në emër të shoqërisë dhe nga të ardhurat e shoqërisë, ka tërhequr dhe ka përdorur shuma parash, për shpenzime të jetesës personale dhe familjare, duke i konsideruar dhe si të ardhura personale, ndër të tjera, edhe për faktin se ai (z.M.), pagën që merrte nga shoqëria, ia kthen sërish mbrapsht shoqërisë, në llogaritë e saj (shoqërisë).*

..... Këto veprime si ortak i vetëm i shoqërisë, Z.M., i ka kryer, kur ka qenë nevoja, duke përdorur të ardhura të shoqërisë, edhe për nevoja personale, duke përfshirë edhe huan e dhënë nipit të tij, z. A. Xh., përsa kohë që ai ka proceduar kohë pas kohe me kthimin e këtyre shumave të parave, shoqërisë, nëpërmjet pagës që e kthen mbrapsht në llogaritë e saj (shoqërisë).”

Nga shqyrtimi i deklarimeve të subjektit, si dhe dokumentacionit të depozituar në përgjigje të rezultateve të hetimit, konstatohet se zoti M. pagën e marrë nga shoqëria ku është administrator dhe ortak i vetëm e kthen në llogarinë e kësaj shoqërie, dhe më pas rregullisht kryen tërheqje nga kjo llogari, e cila është hapur pranë Raiffeissen Bank. Nga verifikimi i llogarisë në Raiffeisen Bank, rezulton se ai për periudhën janar-shkurt 2017, ka tërhequr shumat si më poshtë:

Data	Shuma në lekë
05.01.2017	200,000
09.01.2017	180,000
17.01.2017	300,000
27.01.2017	50,000
31.1.2017	500,000
1.2.2017	510,000
2.2.2017	300,000
6.2.2017	30,000
7.2.2017	150,000
9.2.2017	50,000
13.2.2017	80,000
Në total	2, 350, 000

Siç shihet, nga tabela e mësipërme rezulton se në një hark kohor prej tri ditësh, z. A. M. ka tërhequr shumën totale prej 1,310,000 lekë, përveç shumave të tjera të tërhequra, duke u provuar në këtë mënyrë me dokumentacion se nga ana e tij është tërhequr nga banka shuma prej 12,000 euro. Nga verifikimi i tërheqjeve që ka kryer z. M. gjatë vitit 2016, në këtë llogari nuk rezulton që nga ana e tij në një hark kohor prej tri ditësh të jenë tërhequr shuma të konsiderueshme parash, ashtu sikundër ka ndodhur në shkurt të vitit 2017.

Megjithëse ky shtetas ka patur në dispozicion shumën e pretenduar si të dhënë hua nipit të tij, bashkëshortit të subjektit, konstatohet se nuk ka asnjë gjurmë bankare të kësaj huadhënie. Subjekti e ka justifikuar këtë veprim me marrëdhënien midis dajës dhe nipit, si dhe deklaratën noteriale të datës 3.3.2017. Nga ana e Komisionit konstatohet se kjo deklaratë noteriale është nënshkruar në kohën e marrjes së huas, është përgatitur përpara një noteri publik, ka të përcaktuar shumën e dhënë hua dhe afatin kohor të kthimit të kësaj shume.

B/3. Në zbatim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016 i është kërkuar subjektit të rivlerësimi të dorëzojë dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të ardhurave të z. A. Xh. duke qenë se ka paguar shumën 5.000 euro për blerjen e apartamentit.

Subjekti i rivlerësimi ka vënë në dispozicion të ardhurat nga paga të bashkëshortit (për disa vite), si oficer i policisë gjyqësore.

Ajo ka bashkëlidhur dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim, datë 14.1.2019 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë;
- Vërtetim, nr. ***, datë 14.1.2019 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, për të ardhurat e z. A. Xh. për periudhën 11.1.2016-8.12.2018.

Nga analiza financiare e të ardhurave të subjektit dhe bashkëshortit të saj, rezulton se i kanë patur mundësitë për të kursyer shumën prej 5,000 euro, që ka shërbyer si pjesë e burimit të të ardhurave për blerjen e apartamentit.

UKT-ja konfirmon se z. A. Xh. ka kontratë me nr. *** me adresë: rruga "****", e cila përkon me adresën e apartamentit të blerë në vitin 2017. Më datë 31.5.2017 është bërë kërkesa për ndryshim emri pranë UKT-së nga z. A. Xh.

Nga ana e OSHEE-së konfirmohet se z. A. Xh. ka kontratë furnizimi për këtë apartament. Kjo kontratë ka qenë në emër të pronarëve të mëparshëm, e hapur më datë 20.1.2014. Kalimi i kontratës në emër të A. Xh. është bërë më datë 4.7.2017.

Nga ana e Komisionit është bërë një hetim i thelluar për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimi si më poshtë:

Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimi deklaroi këto pasuri (DPV 2017):

- Apartament banimi, me numër pasurie ***, ndodhur në rrugën "****", pallati ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë, me sipërfaqe 55.6 m², në bashkëpronësi me nënën.

Burimi: Ligji nr. 76523, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore".

Apartamenti është blerë me kontratë shitblerje datë 20.1.1994, për shumën 4,310 lekë.

- Automjet tip Daimler, vit prodhimi 2003, blerë më 14.12.2016, në shumën 1.100 euro+ transport 300 euro+ zhdoganim 51,603 lekë.

Bazuar në shkresën e DPSHTRR-së, rezulton se z. A. Xh. ka në pronësi automjetin me targa ***.

Nga dosja e mjetit rezulton se polica e sigurimit e prerë më datë 15.12.2016 për periudhën 15.12.2016-14.12.2017, ka si përdorues znj. Esmeralda Çeka. Bazuar në deklaratën doganore "Import 4", datë 14.12.2016, të nxjerrë nga sistemi ***, rezulton se mjeti është blerë për shumën 1.100 euro dhe janë paguar detyrimet në shumën 51,109 lekë.

Në lidhje me këtë mjet, nga polica e sigurimit e prerë më datë 28.12.2016 për periudhën 28.12.2016-27.12.2017, tek policëmbajtësi, si përdorues rezulton subjekti i rivlerësimit.

Burimi i blerjes së këtij automjeti janë të ardhura e përfuara nga shitja e automjetit me targa *** me kontratë nr. ***, datë 9.12.2016, për shumën 4.500 euro.

Nga hetimi administrativ, si dhe informacioni i grumbulluar, nuk kanë lindur paqartësi apo dyshime në lidhje me këto pasuri.

Konkluzioni përfundimtar mbi vlerësimin e pasurisë së subjektit

Pasi u hetua në mënyrë të thelluar mbi të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Esmeralda Çeka ka deklaruar saktë në deklaratën "Vetting".

Komisioni çmon se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të veta, si detyrimi kryesor kushtetues i tij. Subjekti nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, si dhe nuk ka asnjë indicie për fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Esmeralda Çeka, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2017 për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Si përfundim, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit znj. Esmeralda Çeka.

Në deklaratën për kontrollin e figurës, në pjesën 5, subjekti i rivlerësimit deklaroi se djali i dajës, z. Q. B., ka dajeni që është dënuar në Greqi rreth vitit 2000, por nuk ka dajeni për veprat penale konkretet për të cilat është dënuar.

Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Nga hetimi i Komisionit rezulton

që shtetasi Q.B ka qenë i dënuar për vepra penale që përfshihen në krimin e organizuar, por nuk rezultoi që subjekti të ketë kontakte në kuptim të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016 me këtë shtetas

Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Esmeralda Çeka, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta dhe nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe më pas ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 5.3.2019.

Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale, i kryer nga KLGJ-ja, është bazuar në:

- 1) Formularin e vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore, të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera, që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 2) 5 (pesë) dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) Të dhënat nga burimet arkivore të ish-KLD-së.

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nga ana e Komisionit u bazua në gjetjet e këtij raporti, në shpjegimet e dhëna nga subjekti, dhe pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku u konstatua:

1. Aftësitë profesionale:

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret.

Subjekti i rivlerësimit kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile objekt shqyrtimi gjyqësor. Zbaton me korrektesë procedurën e gjykimit të shkurtuar. Në të gjitha rastet, përdor praktikën e Kolegjit Penal dhe Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë apo vendimet unifikuese, ligjet e veçanta dhe aktet nënligjore. Subjekti i rivlerësimit ka njohuri në të drejtën penale, ku kombinon rregullat e pjesës së përgjithshme me ato të pjesës së posaçme të Kodit Penal. Gjithashtu, ajo ka njohuri edhe në të drejtën procedurale penale,

rregullat e aplikimit të gjykimit të shkurtuar. Përdor aktet ndërkombëtare, siç është Konventa e OKB-së, "Për të drejtat e Fëmijëve".

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj janë të kuptueshme. Ajo respekton rregullat e drejtshkrimit dhe në të gjitha rastet përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme dhe e standardizuar. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Në përgjithësi përdor referenca në jurisprudencën e gjykatave më të larta, u referohet vendimeve unifikuese, përdor praktikën e gjykatave më të larta. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Ajo përgjithësisht i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, ku pasqyrohet edhe shkaku ligjor.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti rivlerësimit në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013-8.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013-8.10.2016, gjyqtarja Esmeralda Çeka ka gjykuar gjithsej 1.138 çështje, prej të cilave 443 penale, (nga këto: 202 penale themeli; 67 kërkesa penale; 174 masa sigurimi) dhe 695 çështje civile, (nga këto: 177 civile themeli; 220 familjare; 76 kërkesa civile dhe 222 urdhra ekzekutimi).

Sipas pikës 3, germa "g" e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që nuk është e organizuar në seksione, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje) dhe çështjes civile me palë kundërshtare. Nga ana tjetër, germa "k" e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit ka përcaktuar se kryetari i gjykatës në funksionin e gjyqtarit nënkupton realizimin nga ata brenda një viti kalendarik të një ngarkese pune minimale, respektivisht në masën 40 % të ngarkesës minimale të punës së gjyqtarit të asaj gjykate. Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 240 gjykime çështjesh të tilla për tre vjet. Sipas të dhënave statistikore konstatohet se ngarkesa sasiore e subjektit të rivlerësimit ka qenë mbi standardin minimal, duke gjykuar me një ngarkesë, gati sa dyfishi i sasisë minimale të përcaktuar.

Kohëzgjatja e gjykimeve nga subjekti i rivlerësimit, nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se ka qenë në intervale kohore nga 1 ditë deri në 14 muaj e 4 ditë. Në 2 raste është tejkaluar afati standard i gjykimit prej 6 muajsh.

Aftësitë e saj organizative janë bërë edhe objekt ankesash. Konkretisht, Inspektorati ka verifikuar një ankesë qytetarësh, që ngrinin pretendime për mosrespektim formal të ligjit.

Në këtë rast, ankesa i është regjistruar për vlerësim profesional dhe etik për zvarritje, për mosrespektim formal të ligjit. Nuk ka kërkesa për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore, (*shih* të dhënat nga Burimet Arkivore të ish- KLD-së).

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit, është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit i ka kushtuar rëndësi të veçantë arsyetimit në kohën e duhur vendimeve gjyqësore.

Sipas analizës të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit përgjithësisht e respekton afatin e gjykimit dhe veçanërisht në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, si një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore.

Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje shpejt, me marrjen e akteve të çështjes me short, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Distancat kohore midis seancave janë të arsyeshme dhe në raport me shkakun për të cilin seanca është shtyrë. Ajo zhvillon dhe dokumenton procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Orienton drejt debatin dhe hetimin gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve gjer në dhënien e vendimit përfundimtar. Disponon me vendime të ndërmjetme për çdo veprim procedural të kryer gjatë gjykimit, duke shënuar dhe referencat ligjore procedurale.

Në një rast gjyqtarja shprehet me vendim të ndërmjetëm se pranon kërkesën e palës paditëse për shtimin e objektit të padisë, por nuk ia njofton këtë vendim palëve në mungesë, konform nenit 185 të K.Pr.Civile. Ky moment procedural nuk ka sjellë pasoja për palët, pasi vendimi është ankimuar dhe është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, përgjithësisht nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të.

Në çdo dosje të vëzhguar, subjekti ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore, vendime të cilat janë marrë në afate të shkurtra nga 0 - 3 ditë, pas marrjes së çështjes me short. Regjistimi i çështjes dhe hedhja në short, kryesisht në çështjet civile dhe penale, janë bërë brenda të njëjtës ditë në tre raste, dhe brenda 3 ditëve në dy rastet e tjera.

Në çështjet penale seancat janë caktuar brenda afatit ligjor 15- ditor, vetëm në një rast është tejkaluar ky afat për shkak të lejes vjetore.

Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesëpapia apo kërkesa penale për gjykim, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, apo vendimet përfundimtare, fletëhirrjet, provat, etj.

Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit.

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 5.7.2002 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2008. Në datën 25.3.2009, ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Nga data 23.7.2014, ushtron edhe detyrën e kryetares së kësaj gjykate.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me cenimin e integritetit të saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Për këtë gjyqtare, në asnjë rast, prej 5 dosjeve të vëzhguara, nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Në 3 dokumentet ligjore të paraqitur dhe në 5 dosjet e tjera të vëzhguara nuk janë konstatuar çështje të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar as përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementeve të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e tjera të vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar rregullat procedurale, që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se subjekti i rivlerësimit komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

Ndonëse janë evidentuar raste, që të ketë patur vonesa në fillimin e seancave gjyqësore apo dështim të seancave të planifikuara, këto nuk kanë ardhur për shkak të mungesës së bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

c) Gadishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 11 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Këto të dhëna tregojnë se ajo ka marrë pjesë në 20 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trivjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, të paorganizuar në seksione. Nuk dokumentohet që subjekti i rivlerësimit të jetë angazhuar në aktivitete të tjera profesionale, jashtë Shkollës së Magjistraturës.

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është bazuar edhe në 4 denoncime të bëra pranë Komisionit. Pas shqyrtimit të këtyre denoncimeve, konstatohet se në asnjë prej tyre nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptive nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Në përfundim të kësaj analize, në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit Esmeralda Çeka, konstatohet se ky subjekt ka treguar cilësi shumë të mira në punë, arsyetim dhe gjykim të drejtë, identifikon dhe analizon drejt problemet. Ajo njeh shumë mirë parimet e së drejtës si: respekton në arsyetim të drejtat e palëve, është efiçente dhe efektive.

D. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej tij, konstaton se subjekti ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa "a", si dhe të nenit 59, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Esmeralda Çeka.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerëve Publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.



3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 18.4.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

ETLEDA ÇIFTJA

Kryesuese

PAMELA QIRKO

Anëtare

GENTA TAFI (BUNGO)

Relatore



Sekretare gjyqësore

FIGRELA MANDRO